

AKT THEMELIMI

i

SHOQERISE "ALFARMAKOS" SHPK

Ne te nenshkruarit:

- Sali Man Preçi
- Altin Fasli Malaj

Mbledhur sot me date 30 Gusht 2005 ne Tirane,ne baze te Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare", me vullnetin tone te lire vendosem te themelojme shoqerine "ALFARMAKOS" SHPK sipas permbajtjes se ketij akti themelimi dhe statutit bashkengjitur, si me poshte:

1. Themelojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emrin "ALFARMAKOS" SHPK.
2. Ne te gjitha aktet zyrtare me te tretet si dhe ato te brendshme te saj do te shenohen detyrimisht inicialet "ALFARMAKOS" SHPK
3. Shoqeria do te kete per objekt te veprimtarise se saj :

-Import-eksport,tregtim me shumice e pakice te artikujve farmaceutike;
-Tregtimin e artikujve te ndryshem qe perdoren ne sektoret e shendetesise si: instrumente e paisje mjeksore, detergjente, lende te para e materiale per produkte mjeksore e spitalore , mallra te ndryshem per furnizim te klinikave, laboratoreve, spitaleve dhe institucioneve te tjera te ngjashme;
-Import eksport e tregtim te lendeve te para e materialeve,te mallrave industriale e ushqimore per konsum,ndertim ,prodhim e sherbime te çdo lloji.
-Sherbime te konsulences,asistences,studimeve e projekteve ne fushen e shendetesise per sektoret publike e privat.



4. Selia e shoqerise "ALFARMAKOS" SHPK do te jete ne Tirane, me adrese: Rr."Selaudin Zorba " Nr.49 dhe do te kete deget e saj ne rrethe ne territorin e Republikes se Shqiperise. Selia e shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ose te administratoreve te saj.

5. Kapitali themeltar i shoqerise do te jete 100 000 leke. Ai eshte i ndare ne 100 pjese me vleren nominale prej 1000 leke per cdo pjese te kapitalit.

Pjesemarrja ne kapitalin e shoqerise "ALFARMAKOS" eshte si me poshte vijon :

1.Sali Man Preçi, qe zoteron 51% te pjeseve te kapitalit te perbera nga 51 pjese me vlere 51 000 leke dhe,

2.Altin Fasli Malaj, qe zoteron 49 % te pjeseve te kapitalit te perbera nga 49 pjese me vlere 49 000 leke.

6. Organet drejtuese te shoqerise "ALFARMAKOS" SHPK jane :

- Ansambleja e pergjithshme e ortakeve e cila perbehet nga te gjithe ortaket e shoqerise dhe ,
- Bordi Administrativ

7. Shoqeria "ALFARMAKOS" SHPK ka dy administratore te cilet perbejne Bordin Administrativ-Administratori i Pergjithshem dhe Administratori. Administratori i Pergjithshem i shoqerise eshte z.Sali Preçi dhe Administratori i saj eshte z.Altin Malaj. Administratori i Pergjithshem e perfaqeson shoqerine para te treteve,por aktet e administratorit jane gjithashtu njelloj te vlefshme dhe ngarkojne ne te njeten mase me pergjegjesi shoqerine para te treteve. Bordi Administrativ i shoqerise emerohet e shkarkohet nga Ansambleja e ortakeve me shumice te thjeshte votash.



8. Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj per nje peridhe kohe te pacaktuar .
9. E gjithë veprimtaria e shoqerise "ALFARMAKOS" kryhet ne perputhje te plote me aktet ligjore dhe nenligjore te shtetit shqiptar si dhe te statutit te shoqerise, i cili eshte pjese e pandare e ketij akti themelimi.

ORTAKET THEMELUES

Altin Malaj Sali Preçi

Altin Malaj

Sali Preçi

Ne Tirane.me date 30 gusht 2005

